



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Procesverbali i Kuvendit të Punës së FBK-së 13.03.2024, Prizren

AGJENDA

- 16:00-16:30 Arritja e delegatëve në Innovation&Training Park Prizren" (ITP)
- 16:30-17:45 Kuvendi i Punës i FBK-së
- 17:45 – 18:30 Pritje simbolike me rastin e iftarit

FTESA

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së

KONVOKON

Mbledhjen e Kuvendit të Punës të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) më datë 13.03.2024 (e mërkurë) në "Innovation&Training Park Prizren" (ITP) <https://itp-prizren.com/> me fillim nga ora 16:30 dhe me këtë

REND DITE

1. Zgjedhja e Trupave Punues
 - a. Kryesisë së Punës
 - b. Komisionit Verifikues
 - c. Procesmbajtësit
2. Aprovimi i Procesverbalit nga Kuvendi i Punës i datës 22 mars 2023
3. Draft Raporti i Punës për vitin 2023
4. Draft Raporti i Auditimit 2023
5. Draft Plani i Veprimt 2024
6. Draft Plani Financiar 2024
7. Draft Plani i Marketingut 2024
8. Të ndryshme.

Singerisht,
Arben **FETAHU**
Kryetar, FBK



Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Hyrje

Kuvendi i Punës së Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) u mbajt më 13 mars 2024 në Innovation & Training Park, Prizren. Kuvendi filloi në ora 16:30 dhe u kryesua nga Kryetari i FBK-së, z. Arben Fetahu në prani të Sekretares së Përgjithshme të FBK-së, Elvira Dushku.

Para se të filloj mbledhjen, Kryetari i FBK-së tha se sot janë bërë pikërisht nëntë (9) vjet nga pranimi i FBK-së në FIBA dhe në të njëjtën kohë i falënderoi të gjithë brezat për kontributin e dhënë në zhvillimin e basketbollit në vendin tonë dhe për punën në ndërkombëtarizimin e basketbollit kosovar.

Pas kësaj, Kryetari Fetahu kërkoi një (1) minutë heshtje në nderim të jetës dhe veprës së vëzhguesit të basketbollit, Nexhdet Hoxha, i cili u nda nga jeta më 12 mars.

Të pranishmit miratuan rendin e ditës të Kuvendit të Punës pa asnjë vërejtje.

Në vazhdim konform rendit të ditës u zgjedhën trupat punuese të Kuvendit:

Kryesia e Punës:

Kryetari, z. Arben Fetahu, dhe Linda Shala e Fatmir Gashi.

Komisioni Verifikues:

Shkumbin Kumnova, Xhelil Gashi dhe Izet Tahiri.

Procesmbajtës/e:

Edin Kërveshi.

Komisioni Verifikues konstatoi se ka kuorum të mjaftueshëm që të vazhdohet më tutje, pasi nga 32 delegatë sa numëron Kuvendi, të pranishëm ishin 25.

Para se të vazhdohet me rendin e ditës, Shaqir Totaj - Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës e mori fjalën dhe paraqiti raportin e përgatitur për Kuvendin e Punës të FBK-së. Totaj i informoi delegatët e pranishëm për takimin e mbajtur me Sekretaren e Përgjithshme, Menaxheren e Financave dhe Këshilltaren Ligjore për Sport në FBK dhe frymën e mirë të punës që po mbizotëron në Federatë. Ai theksoi se në bazë të gjetjeve, puna që po bëhet në Federatë është për çdo lëvdatë dhe se nuk ka asgjë të jashtëzakonshme për të raportuar përveçse:

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

- KM sugjeron që në Statusin e FBK-së të shtohen më shumë nene rreth transparencës dhe mbrojtjes së integritetit të brendit të FBK-së.
- KM sugjeron që FBK të përpiloj edhe një plan të detajuar rreth shlyerjes së detyrimeve.
- KM sugjeron që FBK të themeloj në të ardhmen departamentin e dedikuar për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, të cilat do të jenë në dobi të basketbollit nga aspekti zhvillimor, marketingut dhe raportimit.

Kryetari i FBK-së pyet delegatët për miratim apo jo të Procesverbalit nga Kuvendi i Punës i FBK-së i mbajtur në Prishtinë më 22.03.2023 dhe delegatët miratuan procesverbalin e punës pa asnjë vërejtje.

Rrjedha e Kuvendit

Në vazhdim Kryetari Fetahu raportoi për aktivitetet e vitit 2023, raportin e auditimit 2023, si dhe paraqiti planet për 2024, të veprimit, financiar dhe të marketingut, si dhe në fund paraqiti një raport përmbledhës për zbatimin e planit strategjik të FBK-së 2021-2025 (vetëm për periudhën e deritanishme 2021-2023).

Raporti i Punës

Tek raporti i punës, Kryetari Fetahu foli për përfaqësimin ndërkombëtar, garat vendore në të gjitha kategoritë dhe të dyja konkurrencat, për paraqitjen e klubeve tona në arenën ndërkombëtare, për Ligën Unike, për trajnimet/seminaret për trajnerë/gjyqtarë/vëzhgues, projektet zhvillimore, organizimet e garave ndërkombëtare në vendin tonë, për ngritjen e kapaciteteve, si dhe foli për sfidat me të cilat jemi ballafaquar si Federatë në vitin 2023, e që kryesisht lidhen me financat, zhvillimin e lojtarëve/eve, trajnerëve/eve, referëve/eve, mbrojtjen e integritetit të garës, dhunën që ka dominuar në disa ndeshje nëpër palestra, mungesën e infrastrukturës, mungesën e rezultateve pozitive etj.

Raporti Financiar

Tek raporti financiar Kryetari Fetahu theksoi se gjatë vitit 2023, në krahasim me vitin 2022, të hyrat e FBK-së u rritën për 61%, ku gjatë vitit 2022 kishim total 1,338,618 Euro, kurse gjatë vitit 2023 total 2,152,416 Euro, apo një rritje prej 813,798 Euro. Sipas tij të hyrat nga MKRS janë rritur dukshëm, 52%, përderisa ka rënie tek të hyrat nga sponsorët, ku në 2024 duhet punuar dukshëm më shumë (21% në

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BP PRINATIS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

2023,6% rënie). Shpenzimet totale janë 1,960,353 EUR (42% më shumë se sa në vitin 2023) e ku shpenzimet me përqindje më të mëdha janë për:

- Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit për të gjitha Përfaqësueset e Kosovës (ceki), Qendra Nacionale, Liga Unike, YDF, organizimet e eventeve ndërkombëtare 5x5 dhe 3x3, etj.(16,89%);
- Pagat e personave zyrtarë të ndeshjeve
- Rritje prej 62% nga viti 2022, apo në vlerë prej 90,726.00 Euro, si rezultat i rritjes së taksave për persona zyrtarë të ndeshjeve me vendim të Bordit të FBK-së (12,14%);
- Paga dhe mëditje për pjesën tjetër të pagesave ndaj personave fizik të angazhuar për të kryer shërbime ndaj FBK-së (13,02%).
- Pagat e stafit të FBK-së (10%)
- Shpenzimet për LED Reklammat, Rekuizitat Sportive dhe Brendim (9,73%).

FBK e ka përmbyllur vitin me detyrime afatshkurta në vlerë prej 352,046 Euro, 80,542 Euro më shumë se vitin 2022, apo 29%. Prej këtyre 61,632 Euro ndaj furnitorëve, 60,000 Euro parapagime nga sponsorët, 51,511 Euro ndaj personave fizik, 42,162 Euro detyrime tjera, 136,740 ndaj ATK-së.

Plani i Veprimit 2024

Kryetari Fetahu foli për objektivat strategjike për vitin 2024 e ato janë:

- Zhvillimi dhe fuqizimi i klubeve anëtare të FBK-së nëpërmjet programeve të qeverisjes së mirë;
- Masivizimi i basketbollit 3x3 në shkolla dhe basketbollit 3x3 elitare;
- Rritja e të hyrave në FBK;
- Zvogëlimi i deficit financiar;
- Integriteti në Sport (drejtësia, gjithë përfshirja, ndershmëria, besimi, vlerat, etika, morali, besimet, respekti dhe loja korrekte);
 - Fillimi i zbatimit të projektit "Safeguarding the Future"
 - Fuqizimi i projekteve FIBA Europe Youth Development Fund, FIBA Europe Girls Program, Jr. NBA, Mini-Basketbollit;
 - Vazhdimi i edukimit të trajnerëve/eve të basketbollit në Kosovë;

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



IMP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

- Rritja e numrit të refereve femra;
- Rritja e numrit të administratoreve femra;
- Organizimi dhe bashkë-organizimi i 5 eventeve të FIBA dhe FIBA 3x3 në nivelin e kërkuar;
- Promovimi i Kosova U16 Meshkujt në Divizionin B;
- Identifikimi i lojtarëve/e vendor/e nga jashtë vendi – potencial për Përfaqësueset e Kosovës në të dyja konkurrencat;
- Fuqizimi i imazhit të Përfaqësueseve në të dyja konkurrencat;
- Investimi në burimet njerëzore të FBK-së;
- Vazhdimi i projektit të Ligës Unike në të dyja konkurrencat;
- Zhvillimi i mëturjeshëm i brendit/markës të Federatës së Basketbollit të Kosovës;
- Rritja e numrit të projekteve të fituara në Erasmus+ dhe organizimi i projekteve të përbashkëta me Ambasadat e huaja e organizata të tjera në Kosovë për promovimin e vlerave të përbashkëta.

Sipas Kryetarit Fetahu implementimi i këtyre objektivave strategjike do të bëhet nëpërmjet:

- Garave të FBK-së
- Klubeve dhe anëtarëve të saj
- Aktiviteteve të Përfaqësueseve të Kosovës
- Aktiviteteve të Basketbollit 3x3
- Aktiviteteve për trajnerët
- Aktiviteteve për personat zyrtarë të ndeshjeve
- Programeve dhe projekteve zhvillimore
- Projekteve të veçanta me Erasmus +
- Ngritjes së kapaciteteve njerëzore
- Zhvillimit të Diplomacisë Sportive
- Organizimit të eventeve vendore e ndërkombëtare dhe aktiviteteve të tjera
- Akteve normative (të reja dhe përditësimi i atyre aktuale)

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Plani Financiar 2024

KATEGORIA E SHPENZIMEVE	VLERA NË EUR	VLERA NË %
Shpenzimet e zyrës	€ 113,000.00	4.98%
Pagat e stafit	€ 212,654.25	9.37%
Përfaqësueset Seniore të Kosovës	€ 212,206.00	9.35%
Përfaqësueset e Reja të Kosovës	€ 187,821.00	8.27%
Liga Unike Trajnimit/Klinikat për persona zyrtarë të ndeshjeve	€ 54,400.00 € 25,240.00	2.40% 1.11%
Trajnimit/Klinikat për Trajnerë	€ 16,983.00	0.75%
Shpenzimet operative dhe logjistike për organizimin e të gjitha ligave	€ 551,946.75	24.32%
Projektet me Erasmus+	€ 62,972.04	2.77%
Basketbolli 3x3	€ 69,349.99	3.06%
Organizimi i FIBA Kampionateve Evropiane	€ 473,917.00	20.88%
Eventet/Projektet tjera	€ 196,066.32	8.64%
Projektet me FIBA	€ 29,940.00	1.32%
Udhëtimet Zyrtare	€ 11,380.00	0.50%
Të tjera	€ 51,900.00	2.29%
TOTALI I SHPENZIMEVE	€ 2,269,776.35	100.00%

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





PËRSHKRIMI I LINJËS BUXHETORE TË HYRAVE	SHUMA
Të hyrat nga MKRS	€ 633,329.00
Të hyrat nga FIBA	€ 274,740.00
Të hyrat nga sponsorizimet	€ 1,039,450.00
Të hyrat nga partnerët e huaj	€ 102,639.36
Të hyrat vetanake(Kootizimet,regjistrimet e lojtarëve, licensimet, personat zyrtarë, ejt)	€ 136,622.99
Të hyrat nga KOK/Komunat, etj	€ 17,600.00
Të hyrat nga organizimet	€ 65,395.00
TOTALI I TË HYRAVE	€ 2,269,776.35

Në vazhdim Kryetari Fetahu foli edhe për sfidat e pritshme për FBK-në për vitin 2024 e që sipas tij janë:

- Menaxhimi i burimeve financiare/Financimi është gjithmonë një sfidë për Federatën e Basketbollit të Kosovës.
- Marketingu dhe sponsorizimi/FBK duhet të jetë në gjendje të sigurojë sponsorë të mjaftueshëm dhe të ndërmarr fushata të suksesshme marketingu për të rritur ndikimin në publik dhe të sigurojë mbështetje të nevojshme financiare.
- Konkurrenca ndërkombëtare/Përfaqësueset e Kosovës, dy konkurrencat, të gjitha kategoritë mund të përballen me një konkurrencë të fortë në gara ndërkombëtare.
- Zhvillimi i talentit/Gjetja, zhvillimi dhe mbajtja e talentëve të reja në basketboll është gjithmonë një sfidë për FBK-në. FBK dhe klubet e saj duhet të investojnë në strukturat bazë nëpërmjet programeve aktuale dhe atyre që pritet të vijnë si në nivel të Qeverisë, FBK-së dhe klubeve.

Në përmbyllje të prezantimit Kryetari Fetahu paraqiti edhe të arriturat dhe "dështimet" gjatë zbatimit të planit strategjik të FBK-së 2021-2025, duke raportuar

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BP PRINETS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

vetëm për periudhën e deritanishme. Fetahu theksoi se gjatë kësaj periudhe është bërë punë e mirë, por që kanë çaluar në disa elemente e që kryesisht lidhen me basketbollin në fushën e lojës, në krijimin e talentëve dhe identifikimin e tyre, si bazë për sukses në të ardhmen, si për ekipet tona, ashtu edhe për ekipet nacionale. Megjithatë Fetahu theksoi se bashkërisht me klube do të punojnë edhe më shumë në këtë drejtim, sepse interesi është i dyanshëm, vullneti nuk mungon dhe që sipas tij kjo është shumë e rëndësishme.

Nuk pati asnjë vërejtje për raportet 2023 dhe planet 2024 andaj ato u miratuan njëzëri.

Pas prezantimit të kryer nga ana e Kryetarit Fetahu, fjalën e kërkoi Presidenti i klubit Sigal Prishtina, Blerand Stavileci, i cili ndër të tjera tha:

- Në prezantim u paraqitën numra të rritur si tek lojtarët/et, trajnerët/et, gjyqtarët/et, por se krahas sasisë duhet punuar në cilësi, pra në krijimin e kuadrove cilësore.
- Gjyqtarët të dërgojnë CV në FBK dhe FBK ta ndajë me klubet, sepse unë dua ta di se a kanë integritet personat që e ndajnë drejtësinë në ndeshjet e klubeve tona. KB Sigal Prishtina do të insistoj që gjyqtarët vendorë të ndajnë drejtësinë në play off, por së pari duam ta dimë se cili është integriteti i tyre. Vitin e kaluar FBK i ka paguar për finalet e play offit të Superliga Meshkujt për sigurimin e shërbimeve të referëve të huaj rreth 30 k dhe nuk besoj se duhet vepruar njëjtë edhe sivjet, sepse duhet t'ua besojmë punën gjyqtarëve tanë. Insistoj që të mbahen takime në mes klubeve dhe gjyqtarëve.
- Bashkëpunim më i madh në mes klubeve dhe FBK-së, sepse pa klube nuk ka FBK, mendoj se duhet gjetur një rrugë të përbashkët për zhvillimin e basketbollit në të gjitha sferat.
- Inkurajoj FBK-në që të organizoj seminare/punëtori për klubet në temat e marketingut, dhe zhvillimit të brendshëm të klubeve, si dhe në zhvillimin e avancimin e drejtorëve sportivë të klubeve.
- Po ashtu mendoj se administrata e FBK-së po e bën një punë të shkëlqyeshme, por duhet kërkuar një model që klubet ta menaxhojnë si një

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Iloj shoqate për klubet e Superligës, pra të marrin përsipër menaxhimin e të drejtave televizive. Dhe këtu duhet krijuar një fond i përbashkët për zhvillimin e gjyqtarëve dhe trajnerëve vendorë në mënyrë që të në të ardhmen të mos kemi nevojë për prurje nga jashtë vendi. Jemi të gatshëm ne si klube me jep diçka që të ndihmojmë në krijimin e kuadrove.

Kryetari Fetahu pas fjalës së Stavilecit tha se për disa pika që i përmendi FBK është duke punuar dhe siç është organizimi i seminareve e punëtorive që do të fillojnë nga muaji prill i këtij viti, derisa për pikat e tjera tha se bashkërisht me klubet e tjera do të diskutojnë në takimet e radhës që do të organizohen para fillimit të fazës përfundimtare të garave.

Tek pika "Të Ndryshme": Kryetari i FBK-së paraqet kërkesën e KB Hyjneshat për anëtarësim, ku konform Nenit 9 pika 3 anëtarësia në FBK është miratuar nga Bordi i FBK-së në mbledhjen e datës 20 shkurt, dhe tani duhet që Kuvendi me më tepër se 50% të votave të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e **Kuvendit të miratoj atë. Delegatët e Kuvendit e miratuan njëzëri.**

Në vazhdim Kryetari Fetahu pyet të pranishmit nëse dëshirojnë të shtojnë apo të komentojnë diçka tek kjo pikë, por nuk pari asgjë.

Pas kësaj pike Kryetari i FBK-së falënderoi pjesëmarrësit dhe i ftoi në pritjen simbolike të organizuar me rastin e iftarit.

Përmbyllja e Kuvendit

Kuvendi i punës i mbylli punimet në orën 17:55.

Përgatiti:

Edin Kërveshi
Procesmbajtës

Miratoi:

Arben Fetahu
Kryetar

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:

